


prill 2017

gap | analizë

Buxheti 2017

dhe rekomandimet e Komisionit Evropian



Hyrje

Projektligji për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017 është publikuar me 1 nëntor 2016.¹ Sipas Ministrit Hoti, projektbuxheti adreson qëllimet strategjike të hartuara nga Qeveria e Kosovës si dhe "akomodon plotësisht shpenzimet që kanë organizatat e ndryshme buxhetore sa i përket agjendës euro-integruese të Kosovës".² Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën (tutje Raporti i KE-së) për vitin 2016 u publikua në fillim të nëntorit 2016, vetëm pak ditë pasi ishte publikuar projektligji për buxhetin dhe derisa ky projektligj ende nuk ishte diskutuar në parim në Kuvendin e Kosovës.³ Në këtë analizë, kemi shikuar nëse të gjeturat e raportit të KE-së për vitin 2015 dhe 2016 janë adresuar me Ligjin për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017.

Ligji për buxhetin e Republikës së Kosovës është miratuar me 22 dhjetor 2016 në Kuvendin e Kosovës. Kuvendi ka pasur rreth 35 ditë pune kohë në mënyrë që t'i diskutojë të gjeturat e raportit të KE-së për vitin 2016. Gjatë kësaj periudhe, Instituti GAP ka analizuar ndarjet buxhetore për vitin 2017 dhe ka prezantuar para katër komisioneve parlamentare,⁴ lidhur me atë se sa projektbuxheti i vitit 2017 i adreson rekomandimet e raportit të KE-së për Kosovën. Gjithashtu, në mars të vitit 2016, Instituti GAP ka publikuar një raport lidhur me këtë temë, duke analizuar buxhetin 2016 dhe rekomandimet e raportit të KE-së për Kosovën. Edhe ky raport është ndarë me përfaqësuesit e qeverisë dhe kuvendit.⁵

Të gjeturat e kësaj analize tregojnë se megjithëse ka përparime në adresimin buxhetor të rekomandimeve të raportit të KE-së, ka ende disa fusha për të cilat nuk është bërë mjaftueshëm. Në


¹ Ministria e Financave, Buxheti i Republikës së Kosovës, Burimi: <http://bit.ly/2nYkCNP>

² Kuvendi i Kosovës, Transkript i mbledhjes plenare të mbajtur me 22,23,dhe 29 dhjetor 2016, Burimi: <http://bit.ly/2l3dSrM>, faqe 20

³ Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën 2016, Burimi: <http://bit.ly/2fPqxwg>,

⁴ Komisioni Parlamentar për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinorë, Komisioni Parlamentar për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, Komisioni për Zhvillim Ekonomikë,Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

⁵ Për më shumë shih lajmin e Institutit GAP <http://bit.ly/1V0fhOf>



fushën e sundimit të ligjit, për shembull, Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) i është rritur dukshëm numri i punonjësve, por jo edhe Departamentit për Çështje Ekonomike në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë, e cila ka mungesë të stafit. Edhe Prokurorisë Speciale (PS), si institucion kyç për luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar, nuk i është ndarë buxhet për plotësimin e pozitave të kërkuara.

Sa i përket rregullatorëve, përparim është bërë në rritjen e kapaciteteve njerëzore të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave (ARH), mirëpo buxhet i pamjaftueshëm është ndarë për Zyrën e Rregullatorit për Energji (ZRRE) dhe Agjencinë e Kosovës për Eficiencë.

Edhe sa i përket reformës në administratë publike nuk është shënuar përmirësim në rritjen e kapaciteteve të Ministrisë së Administratës Publike (MAP) për monitorimin e kësaj reforme. Gjithashtu, Institutit të Kosovës për Administratë Publike (IKAP) nuk i është rritur buxheti me gjithë nevojën për t'i shtuar trajnimet në disa sektorë.

Brenda Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë (MTI) shihet një përmirësim sa i përket investimeve kapitale për Agjencionin për Metrologji, por departamenteve të tjera nuk u janë rritur kapacitetet buxhetore, sidomos atyre që merren me akreditim dhe standardizim.

Në fushën e medias, Komisioni i Pavarur për Media (KPM) vazhdon të përballet me vështirësi për mbulim të obligimeve financiare dhe me numër të kufizuar të stafit. Radio Televizioni i Kosovës (RTK) edhe këtë vit do të financohet nga buxheti i shtetit, megjithëse afati ligjor për këtë formë të financimit ka kaluar.

Në vazhdim analiza ofron më shumë detaje rreth rekomandimeve të raportit të KE-së dhe adresimit të këtyre rekomandimeve nga buxheti i vitit 2017. Fushat në të cilat janë analizuar rekomandimet buxhetore përfshijnë administratën publike, zhvillimi i tregut për të bërë biznes, punësimi dhe çështjet sociale, sundimit të ligjit, bujqësi, shëndetësi, si dhe sferën e medieve dhe statistikave.

Administrata Publike

Kritikat kryesore të adresuara në raportin e KE-së lidhur me administratën publike kanë të bëjnë me mungesën e kapaciteteve të nevojshme të MAP për monitorimin e procedurave të rekrutimit, implementimin dhe monitorimin e Kornizës strategjike për reformë në administratën publike dhe realizimin e misionit të IKAP.⁶ Buxheti i MAP për vitin 2017 është rreth 18.6 milionë euro, apo 2.4 milionë euro (15%) më i lartë se në vitin 2016. Mirëpo, kjo rritje kryesisht i dedikohet kategorisë së mallrave dhe shërbimeve dhe investimeve kapitale, ndërsa buxheti për paga dhe mëditje ka rënie prej rreth 100 mijë euro (5%).

Si pasojë e burimeve të kufizuara njerëzore dhe financiare, MAP ka pengesa në zbatimin e legjislacionit dhe parimeve në administratën publike. Për implementimin e Strategjisë për modernizimin e administratës publike, sipas Ligjit për buxhetin 2017, do të ndahen 600 mijë euro nga kategoria e investimeve kapitale.




FIGURA 1. NUMRI I LEJUAR I PUNËTORËVE NË MAP SIPAS DEPARTAMENTEVE

Sipas raportit të KE-së, përveç mungesës së stafit në disa departamente kyçe, ka edhe mungesë të profesionalizimit në

⁶ Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën 2016, Burimi: <http://bit.ly/2fPqxdg>, faqe 11, 13,49

administratë publike, dhe kjo si pasojë e ndërhyrjes politike dhe mungesës së trajnimeve. Mungesa e trajnimeve profesionale vjen si pasojë e mungesës së mjeteve financiare për IKAP. Në buxhetin e vitit 2017, nuk është planifikuar rritje e dukshme buxhetore, dhe numri i lejuar i të punësuarve në IKAP ka mbetur i njëjtë. Ndërsa për ndërtimin e objektit të IKAP janë ndarë 900 mijë euro, për dallim nga buxheti i rishikuar 2016 ku për këtë ndërtesë ishin planifikuar të ndahen 58 mijë euro. Ky është viti i katërt me radhë që ky projekt është përfshirë në Ligjin e buxhetit.




FIGURA 2 BUXHETI I MAP-IT SIPAS DEPARTAMENTEVE

Gjithashtu ka një numër të madh të institucioneve dhe agjencive të pavarura të cilat drejtpërdrejt raportojnë në Kuvendin e Kosovës, por Kuvendi nuk ka kapacitete të mjaftueshme mbikëqyrëse.⁷ Përkundër kësaj, nuk është planifikuar ngritja e buxhetit për rritje të stafit mbështetës të Kuvendit.

Problem tjetër është rritja e lëndëve administrative të pashqyrtuara në Gjykatën Themelore të Prishtinës (shih sundimi i

⁷ Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën 2016, Burimi: <http://bit.ly/2fPqxxw>, faqe 12

ligjit). Ky problem duhet të zgjidhet duke siguruar fonde për rritje të numrit të gjykatësve dhe përmirësim të kushteve të punës.⁸

Zhvillimi i tregut

Raporti i KE-së sugjeron që të rriten kapacitetet e Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) dhe ndër të tjera të krijohet një program *aftercare*⁹ për investitorët e huaj.¹⁰ Në kuadër të Sektorit të Promovimit të Investimeve në KIESA punojnë vetëm tre persona. Ky numër është tepër i vogël. Duke marrë parasysh se në vitin 2015 kanë qenë 268 biznese të huaja aktive në Kosovë, kjo nënkupton se një zyrtar është dashur të kujdeset për 90 biznese. Në anën tjetër, një milion euro janë ndarë për zonat ekonomike, por raporti i KE-së kishte kritikuar mungesën e një plani për këto zona¹¹. Përveç mungesës së planit, në KIESA nuk ka as udhëheqës të Sektorit për Zhvillimin e Zonave Ekonomike.

Sipas raportit të KE-së, Agjencia Kosovare për Standardizim (AKS), që operon brenda MTI-së, ka mungesë të stafit. Për më tepër, Raporti sugjeron zgjerim të ofrimit të shërbimeve online. MTI ka kërkuar buxhet që AKS të ofrojë edhe shërbimet e certifikimit, mirëpo buxheti për paga dhe mëditje ka mbetur i njëjtë me vitin e kaluar. Më buxhetin e ndarë për vitin 2017, AKS parasheh se do të realizojë rreth 70% të planit të punës.¹²

Mungesa e kapaciteteve buxhetore është identifikuar edhe tek Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit të Kosovës, mirëpo buxheti i kësaj drejtorie ka mbetur pothuajse i njëjtë me vitin e kaluar. Në tri vitet e fundit, rreth 50% të shpenzimeve të kësaj drejtorie janë mbuluar nga fondet e BE-së. Sipas buxhetit të ndarë për vitin

⁸ Ibid faqe 10

⁹ Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën 2016, Burimi: <http://bit.ly/2fPqxëg>, faqe 53

¹⁰ Sipas UNCTAD "aftercare program" do të thotë një numër aktiviteteve që kanë të bëjnë me shërbime lehtësuese për një investitorë pasi që ai të kryejë investimin. Këtu përfshihen aktivitete mbështetëse për të mbajtur një investim, inkurajimin e investimeve shtesë apo edhe rritja efektit ekonomik në zhvillimin e vendit

¹¹ Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën 2016, Burimi: <http://bit.ly/2fPqxwg>, faqe 36

¹² MTI, Përgjigje me shkrim, 11 mars 2017

2017, kjo drejtori pritet të realizojë rreth 70-80% të planit të punës.¹³

Ndërkaq, për Agjencinë e Metrologjisë së Kosovës, Raporti i KE-së rekomandon që të ketë investime në kualifikime, investim në pajisje dhe rritje të numrit të stafit.¹⁴ Buxheti i kësaj agjencie është rritur për 242 mijë euro (79%) dhe kjo rritje kryesisht do të shkojë në investime kapitale. Tri projektet e reja kapitale për këtë institucion janë në fusha për të cilat raporti i KE-së ka rekomanduar që të rriten investimet. Me gjithë rritjen e investimeve kapitale, me numrin aktual të të punësuarve, agjencia konsideron se do të realizojë rreth 70% të planit të punës.¹⁵

Ngjashëm me këto agjencione, Agjencia për Pronësi Industriale është vlerësuar se ka mungesë të kapaciteteve dhe burimeve për realizimin e kërkesave dhe misionit.¹⁶ Edhe në vitin 2017, numri i lejuar i stafit për këtë agjenci ka mbetur i njëjtë.




FIGURA 3 NDARJA E BUXHETIT PËR DEPARTAMENTET E MTI-SË

¹³ Ibid

¹⁴ Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën 2016, Burimi: <http://bit.ly/2fPqxëg>, faqe 42

¹⁵ MTI, Përgjigje me shkrim, 11 mars 2017

¹⁶ Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën 2016, Burimi: <http://bit.ly/2fPqxxg>, faqe 49

Energjia

Raporti i KE-së ka adresuar çështjen e politizimit të ZRRE-së, mungesën e stafit dhe buxhetit si shqetësimet kryesore.¹⁷ Megjithëse planifikohet një rritje e lehtë për buxhetin e ZRRE-së, buxheti për paga dhe mëditje ka mbetur i njëjtë si në vitin paraprak.

Me gjithë rritjen e investimeve në efikasitet, Kosova ende nuk e ka themeluar Fondin për Efikasitet të Energjisë. Gjithashtu, sipas raportit të KE-së Agjencia e Kosovës për Efikasitet nuk ka staf të mjaftueshëm për të vlerësuar, monitoruar dhe verifikuar progresin ndaj targeteve të caktuara për efikasitet.¹⁸ Buxheti i ndarë për paga dhe mëditje për këtë agjenci këtë vit është ulur.

Transporti

Përkundër vlerësimit të raportit të KE-së buxheti i ndarë për mirëmbajtjen e rrugëve është i pamjaftueshëm, këtë vit buxheti i ndarë për këtë qëllim është zvogëluar edhe më shumë, konkretisht është tre milionë euro më i ulët (30%).¹⁹

Sipas raportit të KE-së përmirësimi i infrastrukturës hekurudhore është në fazë shumë të hershme. Në buxhetin 2017, projekti i vetëm i MI-së sa i përket infrastrukturës hekurudhore është rehabilitimi i Linjës 10 hekurudhore (Fushë Kosovë - Hani i Eleziti) për të cilin janë ndarë 19.2 milionë euro nga klauzola e investimeve. Mungesa e kapaciteteve është identifikuar edhe në ARH.²⁰ Sipas buxhetit 2017, numri i lejuar i stafit është rritur për katër persona.

Punësimi dhe çështjet sociale

Raporti KE-së i vitit 2015 kishte konsideruar që financimi për trajnime profesionale mbetet i pamjaftueshëm, ndërsa në Raportin e vitit 2016 ky konstatim nuk figuron më. Në vitin 2017, buxheti për departamentin e trajnimit profesional në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) është rritur

¹⁷ Ibid, faqe 59

¹⁸ Ibid, faqe 60

¹⁹ Ibid, faqe 57

²⁰ Ibid, faqe 57 dhe 58

për 460.5 mijë euro apo 41.7%. Përveç rritjes së buxhetit për Departamentin e Trajnimeve Profesionale, numri i lejuar i punëtorëve është rritur për një person.

Në raportin e KE-së për vitin 2016, gjithashtu është adresuar si problem mungesa e buxhetit për të implementuar "Strategjinë për Punësim 2014-2020" dhe "Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive", të nënshkruar në mes të sindikatave të punëtorëve dhe Qeverisë së Kosovës në vitin 2014.²¹ Buxheti i ndarë për punë dhe çështje të punësimit ka një përmirësim, pasi që do të rritet për 1.5 milionë euro apo 26%, mirëpo MPMS nuk është përgjigjur në kërkesën tonë nëse ky buxhet është i mjaftueshëm.

TABELA. 1 DALLIMI I NDARJEVE BUXHETORE 2016/2017 SIPAS DEPARTAMENTEVE - MPMS

Programet	Dallimi (€)	Dallimi në %
Pensionet	6,611,303	2%
Mirëqenia Sociale	1,567,995	4%
Puna dhe Çështjet e Punësimit	1,499,317	26%
Zyra për Çështje e Trashëgimisë	(4,576)	-6%
Shërbimet e Administratës Qendrore	76,519	7%

Problem tjetër i adresuar në raportin e KE-së është mungesa e sigurisë në punë dhe mungesa e inspektorëve të punës . Edhe këtë vit, numri i lejuar i inspektorëve të punës ka mbetur i njëjtë me vitin e kaluar, gjithsej 70.

Sa i përket çështjeve sociale, raportet e KE-së për vitet 2015 dhe 2016 kanë adresuar si shqetësim largimin pa bazë të 1,000 personave nga komuniteti i të shurdhërve nga lista e pensioneve.²² Gjithashtu, në raportin e KE-së për vitin 2015 dhe

²¹Ibid, Faqe 51

²² Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën 2015, Burimi: <http://bit.ly/1SKQMSt>, faqe 24

2016 është adresuar mungesa e ndarjes së fondeve për komuna për ofrimin e shërbimeve sociale.²³

Sundimi i ligjit

Njëjtë sikur edhe një vit më herët, raporti i KE-së konstaton se institucionet që merren me sundimin e ligjit kanë mungesë të buxhetit dhe stafit.²⁴ Në Ligjin e buxhetit për vitin 2017, buxheti i ndarë për Këshillin Prokurorial të Kosovës (KPK) është 9.5 milionë euro, një rritje prej 1.2 milionë euro (14%) krahasuar me vitin e kaluar. Ndërsa buxheti për KGJK-në është 21.8 milionë euro, apo 1.1 milionë euro (5%) më shumë se një vit më herët. Por, me gjithë rritjen e buxhetit, nevojat buxhetore të këtyre dy institucioneve mbesin të paplotësuara.




FIGURA 4 NDRYSHIMI NË BUXHET PËR KGJK-NË DHE KPK-NË

Përveç mungesës së stafit, mungon një regjistër i të dhënave për rastet kriminale, nuk ka sistem për menaxhim elektronik të lëndëve dhe nuk ka monitorim zyrtar të gjykatave.²⁵ Në Ligjin për buxhetin e vitit 2016 ishin ndarë 100 mijë euro për "Projektin e audio incizimit për gjykata", mirëpo kjo ndarje buxhetore është larguar me rishikim të buxhetit. Për të njëjtin projekt, në buxhetin

²³ Ibid, faqe 45

²⁴ Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën 2016, Burimi: <http://bit.ly/2f00KDZ>, faqe 12

²⁵ Ibid, faqe 15

e vitit 2017 janë ndarë 150 mijë euro. Gjithashtu, tek KPK është ndarë buxhet për një projekt që është vazhdim nga viti i kaluar për "Sistemin për menaxhimin informativ të lëndëve" i cili është bashkëfinancim me Qeverinë Norvegjeze dhe "Sistemi elektronik për menaxhimin e dosjeve të prokurorëve".

Sa i përket luftës ndaj korrupsionit, raporti i KE-së rekomandon që të rritet numri i prokurorëve special dhe të ofrohen trajnime.²⁶ Në vitin 2016, PS kishte vetëm nëntë prokurorë, një më pak se vitin paraprak, ndërsa pozitat e hapura për rekrutim nuk janë mbushur. Kërkesa e PS-së për miratimin e 11 pozitave të reja nuk është miratuar nga Ministria e Financave (MF), megjithëse numri i lejuar i stafit në PS prej 54 është i paplotësuar.

Edhe sa i përket luftimit të krimit të organizuar, ka mungesë të stafit dhe trajnimeve në PS. Në përgjithësi, agjencitë të cilat janë përgjegjëse për sundimin e ligjit kanë mungesë të ekspertizës dhe pajisjeve për luftimin e çështjeve komplekse të terrorizmit.²⁷ Njësia për Inteligjencë Financiare ka mungesë të stafit dhe mjeteve për të realizuar misionin e saj.²⁸

Në anën tjetër, ka një përmirësim sa i përket numrit të stafit në departamentet që merren me krime të rënda pranë gjykatave themelore.²⁹ Siç shihet nga tabela e mëposhtme, rritja e stafit është bërë duke transferuar stafin kryesisht nga sekretariati i KGJK-së. MF ka lejuar 285 pozita të reja, prej tyre 61 gjyqtarë, 61 zyrtarë ligjor, dhe 163 persona nga pakicat serbe për gjykatat sipas marrëveshjes së Brukselit. Me gjithë rritjen e numrit të lejuar të të punësuarve, 109 pozita të lejuara për punësim në Ligjin për buxhetin mbesin të paplotësuara.

²⁶ Ibid, faqe 16

²⁷ Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën 2016, Burimi: <http://bit.ly/2fPqxdg>, faqe 22

²⁸ Ibid, faqe 70

²⁹ Ibid, faqe 18

TABELA. 2 NUMRI I LEJUAR I PUNËTORËVE NË KGJK PËR VITIN 2017

Programet	Të punësuar 2016	Të punësuar 2017	Diferenca
Gjykata Supreme dhe Dhoma e Posaçme	88	93	5
Sekretariati i KGJK-së	265	87	-178
Njësia e Shqyrtimit të Performancës Gjyqësore	7	7	0
Zyra e Prokurorit Disiplinor	20	20	0
Gjykata e Apelit	111	132	21
Gjykata Themelore në Prishtinë	452	479	27
Gjykata Themelore në Prizren	225	226	1
Gjykata Themelore në Gjiilan	202	214	12
Gjykata Themelore në Ferizaj	168	173	5
Gjykata Themelore në Pejë	231	231	0
Gjykata Themelore në Gjakovë	160	160	0
Gjykata Themelore në Mitrovicë	230	337	107

Problem tjetër sa i përket KGJK-së është adresimi i kontesteve ekonomike. Koha mesatare për zgjidhjen e kontesteve biznesore është 330 ditë.³⁰ Aktualisht Departamenti për Çështje Ekonomike në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë ka katër gjyqtarë të cilët mbështeten me staf prej gjashtë personave nga USAID, përkrahje që do të zgjatë edhe për një vit. Gjithashtu, në Gjykatën e Apelit, përkundër që kërkohen tre gjyqtarë për vendimmarrje, është vetëm një gjyqtarë në Departamentin për Çështje Ekonomike.³¹ Në rishikimin e buxhetit 2016, Komisioni Parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri kishte kërkuar që të rritet stafi në këtë departament,

³⁰ World Bank, Doing Business Ranking, Burimi: <http://bit.ly/2l3G5j7>

³¹ Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, P r o c e s s e r b a l, 21 shkurt 2017

mirëpo kjo kërkesë ishte refuzuar me arsyetimin se nuk ka buxhet.³²

Bujqësia

Sipas raportit të KE-së, procesi i aplikimeve, pagesave dhe subvencioneve në bujqësi pengohet nga numri i vogël i stafit të angazhuar. Agjenca për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB) ende ka mungesa në funksion të pagesave dhe monitorimit të granteve, si dhe të një njësie për auditim të brendshëm.³³ Megjithëse numri i lejuar i të punësuarve në AZHB është rritur për 31 persona (nga 35 në 66 punëtorë), MF i ka aprovuar vetëm 10 pozita të reja për këtë departament për vitin 2017. Sipas Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), rritja e stafit do të përmirësojë gjendjen sa i përket monitorimit të granteve mirëpo numri aktual i të punësuarve është i pamjaftueshëm për të arritur optimumin e kërkuar sipas standardeve evropiane.³⁴

Raporti i KE-së gjithashtu ka adresuar lidhjen e dobët në mes të subvencioneve dhe granteve dhe produktivitetit në bujqësi. MBPZHR ka zgjedh si metodë të subvencionimit njësinë për hektar të kulturës bujqësore ose në blegtori për krerë, e jo subvencionimin bazuar në rendiment apo prodhimtari. Sipas një analize të Institutit GAP, kjo metodë e subvencionimit nuk ka arritur të ndikojë në rritjen e produktivitetit në bujqësi, prandaj duhet të shqyrtohet që kjo të ndryshojë.³⁵

Shëndetësia


Edhe këtë vit, Fondi i Sigurimit Shëndetësor si njëri ndër projektet kryesore sa i përket sektorit të shëndetësisë nuk është përfshirë në buxhet. Ligji për Sigurime Shëndetësore është miratuar në vitin 2014 dhe për implementimin e tij nevojitet edhe funksionalizimi i Sistemit të Informimit Shëndetësorë (SISH) me

³² Kuvendi i Kosovës, Transkripti i mbledhjes plenare të mbajtur me 13 korrik 2016, Burimi: <http://bit.ly/2lyfXhb>

³³ Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën 2016, Burimi: <http://bit.ly/2f00KDZ>, faqe 54

³⁴ MBPZHR, Përgjigje me email, 03 mars 2017

³⁵ Instituti GAP, Analiza për Industrinë e Qumështit, Burimi: <http://bit.ly/1M2IMNW>



një kosto prej 17 milionë euro dhe themelimi i Fondit të Sigurimit Shëndetësor më një pjesë të financuar nga buxheti i Kosovës.³⁶ Edhe në këtë vit ky fond nuk figuron në buxhetin e Kosovës, ndërsa funksionalizimi i SISH-it ende nuk ka përfunduar. Përveç mungesës së sigurimeve shëndetësore, sipas raportit të KE-së të vitit 2015 dhe 2016, shpenzimet publike në shëndetësi janë ndër më të ulëtat në rajon. Sipas Ministrisë së Shëndetësisë (MSH), buxheti për shëndetësi asnjëherë deri më tani nuk i ka plotësuar nevojat.³⁷

Si pasojë, mungesa e buxhetit pengon realizimin e nevojave bazike për shëndetin e nënës dhe fëmijëve dhe shëndetit publik në përgjithësi.³⁸ Sipas MSH-së, kërkesat për buxhet për shëndetin e nënës dhe fëmijës janë munduar t'i plotësojnë me mjete shtesë nga projektet edhe nga donatorët. Raportet e KE-së për vitet 2015 dhe 2016, gjithashtu kritikojnë sektorin e shëndetësisë për mungesën e shërbimeve të mjaftueshme për personat me aftësi të kufizuara.³⁹ Sipas MSH-së, edhe mangësitë sa i përket këtyre shërbimeve janë pasojë e mungesës së buxhetit.

Raporti i KE-së i vitit 2016 kritikon sektorin për fokusim vetëm në investime kapitale përderisa shpenzimet për shëndetësinë primare në mallra dhe shërbime janë të ulëta.⁴⁰ Me buxhetin e ndarë për vitin 2017, mallrat dhe shërbimet për MSH-në do të rriten për 2.1 milionë euro (8%), ndërsa për shëndetësi primare do të rriten për 1.7 milionë euro.

Probleme tjera të adresuara në këtë raport janë: a) mungesa e zbatimit të ligjit për duhanin; b) mungesa e infrastrukturës dhe raportimit për sëmundjet ngjitëse; c) parandalimi i përdorimit të drogave; d) ekzaminimi i sëmundjes së kancerit, etj.

³⁶ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji nr.04/L-249 për Sigurime Shëndetësore, Burimi: <http://bit.ly/1MhAePq>

³⁷ MSH, Intervistë me shkrim, 13 mars 2017

³⁸ Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën 2015, Burimi: <http://bit.ly/1SKQMSt>, faqe 45

³⁹ Ibid, faqe 24

⁴⁰ Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën 2016, Burimi: <http://bit.ly/2f00KDZ>, faqe 51

Mediet dhe statistikat

Komisioni i Pavarur për Media (KPM) ka dështuar të kalojë në sinjalin digjital dhe përgatitjet teknike për këtë proces janë në fazë të hershme. Problematike në aspektin buxhetor është cilësuar mungesa e buxhetit për të plotësuar obligimet financiare dhe realizimin e investimeve kapitale. Me buxhetin e rishikuar 2016, shpenzimet kapitale të KPM-së janë përgjysmuar ndërsa një rritje buxhetore prej 157 mijë euro (53%) planifikohet të realizohet gjatë vitit 2017. Ndërtimi i objektivit të KPM-së është i vetmi projekt kapital i planifikuar në buxhetin 2017 të KPM-së.

Problem tjetër sa i përket kompetencave të KPM-së është mungesa e kapaciteteve për rregullimin e medieve online. Duke marrë parasysh se buxheti për paga dhe mëditje ka mbetur i njëjtë me vitin e kaluar, me numrin e njëjtë të stafit është e vështirë të zgjerohen kompetencat për përfshirje të medieve online në rregullim.





FIGURA 1. BUXHETI PËR KPM

Mbetja e RTK-së nën financimin e buxhetit të shtetit mbetet problem i cili e dëmton pavarësinë editoriale të RTK-së.⁴¹ Sipas ligjit për RTK-në periudha prej tri vitesh e financimit të RTK-së nga buxheti i shtetit ka kaluar.⁴² Në buxhetin e vitit 2017, RTK do të

⁴¹ Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën 2016, Burimi: <http://bit.ly/2fPqxwg>, faqe 24 dhe 25

⁴² Ligji nr. 04/L-046 për Radio Televizionin e Kosovës, Burimi: <http://bit.ly/1YcYIUy>



subvencionohet me 11 milionë euro. Instituti GAP ka kërkuar që me projektligjin e ri RTK të financohet nga parapagimi i qytetarëve, ndërsa fondet nga buxheti i Kosovës të përdoren vetëm me arsyetime të veçanta.

Sa i përket sektorit të statistikave, raporti i KE-së vlerëson se Kosova është në fazë shumë të hershme.⁴³ Një ndër shkaktarët e kësaj është mungesa e stafit dhe mjeteve financiare në Agjencinë e Statistikave të Kosovës (ASK). Përveç mungesës së stafit, ka mungesë të trajnimeve për stafin e ri sa i përket metodave të mbledhjes dhe kualitetit të statistikave. Sipas Raportit, pothuajse të gjitha llojet e statistikave të publikuara nga ASK kanë nevojë të përmirësohen dhe të përshtaten me standardet e BE-së.

Buxheti i ndarë për ASK-në në vitin 2017 planifikohet të rritet për 83 mijë euro (7%), kurse numri i të punësuarve në këtë agjenci pritet të jetë i njëjtë me numrin e të punësuarve në vitin e kaluar (149). Vitin e kaluar, numri i të punësuarve në ASK është rritur për 10 persona. Mirëpo, për shkak se këta persona janë punësuar në kuadër të integritit të strukturave të ashtuquajtura "Mbrojtja Civile", këta persona nuk kanë përgatitje profesionale.⁴⁴

⁴³ Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën 2016, Burimi: <http://bit.ly/2fPqxwg>, faqe 64

⁴⁴ Agjencia e Statistikave të Kosovës, Intervistë me email, 16 mars 2016

Përfundim

Në këtë analizë është diskutuar lidhur me kapacitetet buxhetore të institucioneve të Kosovës në mënyrë që të realizojnë misionin e tyre dhe si rezultat të kemi edhe përshpejtim të procesit të integritetit evropian të Kosovës. Megjithëse ka një përmirësim të kapaciteteve buxhetore në fusha të caktuara, Qeveria e Kosovës duhet t'i jap prioritet rritjes së buxhetit për institucionet të cilat luajnë rol kyç në përmirësim e sundimit të ligjit, zhvillimit të tregut, rritjes së punësimit dhe mirëqenies sociale, përmirësimit të shërbimeve të shëndetësisë, etj.

Edhe pse ka një rritje të buxhetit në institucionet që merren me sundimin e ligjit, ka nevojë të rritet numri i stafit si në prokurori ashtu edhe në gjykata. Gjithashtu, është e nevojshme që të rritet buxheti për investime kapitale në teknologji informative, pajisje të specializuara dhe trajnime në këto institucione.

Tek institucionet të cilat merren me infrastrukturë të cilësisë ka një përmirësim sa i përket kapaciteteve tek Agjencia e Metrologjisë së Kosovës, mirëpo institucionet tjera kanë nevojë për buxhet shtesë veçanërisht sa i përket burimeve njerëzore. Edhe një numër i agjencive të pavarura dhe ekzekutive, siç janë ZRRE dhe Agjencia e Kosovës për Efiçencës të Energjisë kanë nevojë për rritje të stafit.

Sa i përket çështjeve të punësimit, buxheti për trajnime profesionale këtë vit ka një rritje të dukshme. Mirëpo, ka mungesë të kapaciteteve buxhetore për të siguruar numër të mjaftueshëm të inspektorëve për të implementuar Ligjin e punës. Gjithashtu, ka mungesë të stafit për monitorim më të mirë të subvencioneve në bujqësi.

Problemet buxhetore vazhdojnë të mbesin të njëjta edhe këtë vit sa i përket kapaciteteve për të implementuar reformën në administratë publike. Si pasojë e mungesës së buxhetit ka mangësi edhe në monitorim të mediave, ndërsa RTK edhe këtë vit ka mbetur nën financim nga buxheti i shtetit, megjithëse afati ligjor për financim ka kaluar.

Duke u bazuar në këto të gjetura, Instituti GAP rekomandon për Qeverinë e Kosovës që të rrisë buxhetin për këto institucione/projekte:

- **Gjykatat dhe Prokuroria.** Rritjen e buxhetit për rritjen e numrit të prokurorëve, gjykatësve dhe asistentëve. Në mënyrë që të rritet efikasiteti në trajtimin e lëndëve të bizneseve, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet rritjes së stafit në Departamentit për Çështje Ekonomike në Gjykatën Themelore në Prishtinë. Gjithashtu duhet të ndahet buxhet për investime kapitale për teknologji informative dhe pajisje tjera profesionale;
- **MTI.** Krahas ndarjes së buxhetit për zona ekonomike, Qeveria e Kosovës duhet të hartojë plane për këto zona. Gjithashtu duhet të ndahen mjete për funksionalizimin e plotë të institucioneve që merren me infrastrukturë të cilësisë siç janë: Agjencia Kosovare për Standardizim, Agjencia për Pronësi Industriale, Drejtoria e Përgjithshme për Akreditim;
- **Fusha e Energjisë.** Në fushën e energjisë të ndahen fonde për themelimin e Fondit për Eficiência të Energjisë krahas rritjes së stafit për Agjencinë e Kosovës për Eficiência. Gjithashtu, të ndahet buxhet për rritje të stafi të Zyrës së Rregullatorit për Energji;
- **MI.** Krahas ndarjes së buxhetit për shtrimin e rrugëve lokale, regjionale dhe autostradave, duhet të ndahet buxhet i mjaftueshëm për mirëmbajtjen e tyre;
- **MPMS.** Duhet të ndahen fonde për implementimin e "Strategjisë për Punësim 2014-2020" dhe rritjen e numrit të inspektorëve të punës;
- **MBPZHR.** Në mënyrë që të përmirësohet monitorimi i subvencioneve bujqësore të rritet numri i stafit për Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë;
- **MAP.** Të ndihmohet në rritjen e profesionalizimit në administratë publike, përmes rritjes së buxhetit për IKAP-in i cili ofron trajnime për shërbyesit civilë. Gjithashtu, departamenti për Menaxhimin e Reformës në Administratë Publike ka nevojë për burime njerëzore shtesë në mënyrë që të monitorojë Strategjinë për modernizimin e administratës publike në Kosovë;
- **RTK.** Duke marrë parasysh se afati ligjor për financimin e RTK-së nga buxheti i shtetit ka kaluar, duhet që financimi nga buxheti i shtetit për RTK të ndërpritet dhe RTK të financohet nga parapagimi;
- **KPM.** Të ndahet buxhet për rritje të stafit në mënyrë që KPM-së t'i rriten kapacitetet monitoruese edhe për mediat online. Gjithashtu, duhet të ndahet buxhet për mbulimin e shpenzimeve kapitale në KPM.

Instituti GAP është një Think-Tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

Instituti GAP mbështetet nga:



Ky projekt është mbështetur nga:

*Support to
Anti-Corruption Efforts
in Kosovo Project*
— SAEK



Empowered lives.
Resilient nations.

Generously
funded by -

